

REXHEP QOSJA  
PËR  
**Lirinë, të Vërtetën dhe të Drejtën**

---

BOTIMET TOENA



REXHEP QOSJA

PËR

Lirinë, të Vërtetën dhe të Drejtën

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Korrektore letrare: Majlinda Bami *dhe* Sonila Kryeziu

Përkujdesja grafike: Erdita Oshafi

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817341

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420.

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

Liria, e Vërteta dhe e Drejta  
janë Vlerat më të rëndësishme të Mendjes,  
të Jetës, të Shtetit dhe të Kombit.

Popullit, të sotmes dhe të ardhmes së tij,  
i shërbehet ndershëm, sa duhet e si duhet  
duke i njohur, duke i treguar, duke i pranuar,  
duke i vlerësuar, duke i mbrojtur dhe  
duke i trajtuar me mendje e me zemër këto Vlera.



Ai që dëshiron t'ia marrë Lirinë një Kombi më së pari do t'ia kufizojë Lirinë e fjalës.

**Benjamin Franklin**

Në qoftë se pushtetari nuk u përmbahet rregullave morale, edhe qytetarët do të sillen në të njëjtën mënyrë si ai... Anarkia shpesh është e keqe më e vogël sesa despotizmi.

**Monteskie**

Sikur ta dinim gjithë peshën e keqe të gënjeshtres do ta dëbonim me zjarr para të këqijave të tjera.

**Balzaku**

E drejta njerëzore është liria, kurse zbatimi i saj i mëtejme është barazia para ligjit.

**Hegeli**

Në fund nuk do të më kujtohen fjalët e armiqve, por heshtja e miqve.

**Martin Luter King**

Këto janë kohë të vështira, pa prijës.

**Antoni Hopkins**

Europa do të ketë vetëm një gjuhë ose nuk do të jetë Europë, shkroi një ditë njëfarë publicisti, por e vërteta është krejt ndryshe: Europa do të ketë shumë gjuhë ose pak gjuhë me të cilat do të na mësojë që të jemi barbarë!

**Karl Markus Gaus**





## DEKLARATA PËR PAVARËSINË

*1 konsiderojmë vetvetiu të kuptueshme këto të vërteta:*

*Të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë; Krijuesi iu ka dhuruar atyre të drejta të pamohueshme; ndër këto të drejta janë e drejta për jetë, për liri dhe për ndërtim të lumturisë. Njerëzit kanë zgjedhur qeveritë që do t'ua sigurojnë ato të drejta. Pushteti i tyre i ligjshëm buron prej pajtimit të atyre që qeverisën. Çdoherë kur një trajtë e qeverisjes largohet prej këtij qëllimi populli ka të drejtë ta mohojë dhe të krijojë qeveri të re.*

DEKLARATA PËR PAVARËSINË QË KONGRESI AMERIKAN E KA VOTUAR  
MË 4 KORRIK 1776 DHE MARRËVESHJA QË E KA HARTUAR XHEFERSONI

Utopia, 181.



## PARAFJALA

Këtu, në këtë vepër, me lloje të ndryshme të shprehjes mendore, shkencore, publicistike, letrare, janë trajtuar, në radhë të parë, tri çështje të mëdha dhe shumë të rëndësishme: Liria, e Vërteta dhe e Drejta.

Ato janë Vlerat më të rëndësishme të Njeriut, të Mendimit, të Jetës, të Shtetit e të Kombit.

Për to është shkruar nëpër kohë të ndryshme, që nga fillesa e organizimit politik e shtetëror të njerëzve e deri sot.

Për rëndësinë e tyre janë shkruar shumë e shumë faqe, shumë e shumë libra shkencorë, letrarë e publicistikë.

Për rëndësinë e tyre është folur, diskutuar, debatuar në shumë e shumë tubime shkencore, simpoziume, konferenca, kongrese shkencore.

Për rëndësinë e tyre është debatuar e do të debatohet në shumë e shumë kuvende, kryeministri, ministri shtetërore.

Më në fund për to është pësuar, sakrifikuar, luftuar e vdekur shumë, pambarimisht shumë.

Dhe, ndoshta, kurrë pajtimi i plotë për to nuk do të arrihet. Mund të thuhet kështu për arsye se në trajtimin dhe për trajtimin e çështjeve të tilla të mëdha pothuaj gjithmonë dhe pothuaj gjithkund shfaqen edhe pajtime dhe mospajtime të mëdha.

Dhe, për shkak të tyre e për to do të vazhdojnë pësimi, flijimi, lufta e vdekja, sepse gjithmonë do të ketë dashës e urrejtës të tyre, sepse vetë jeta është ndërtuar mbi kundërvënien, antinominë, mbi të mirën e të keqën.

Bindjen e tillë na e dëshmojnë historia njerëzore botërore dhe kulturat e lashta, antike. Ka të dhëna që dëshmojnë se për to, për rëndësinë e tyre jetësore, politike, shtetërore, është folur e është shkruar shumë ta themi në Greqinë antike e në Perandorinë Romake. Dhe, në Egjiptin e lashtë, dhe në Lindjen e largët. Dhe, janë shfaqur mendimet më të ndryshme.

Për to kanë folur e shkruar filozofët më të mëdhenj të botës si Platoni, Aristoteli, Herakliti, Dekarti, iluministët e mëdhenj, Volteri, Didëroi,

Dalamberi, Rusoi, mandej idealistët e mëdhenj gjermanë, Kanti e Hegeli, dhe marksistët e mëdhenj, Marksi, Engelsi, Lukaçi. E të tjerë.

Unë, natyrisht, nuk do të merrem me teorinë e këtyre vlerave të mëdha të njerëzimit. Unë, këtu, do të trajtoj praktikën, jetën, politikën, në shtetet tona në të cilat ato Vlera sendërtohen në mënyrat më të ndryshme, kur adhuruese e kur mohuese që prej disa vetave adhurohen e mbrohen e prej disave mohohen.

Kisha idetë, kisha idealet, kisha përkushtimet, kisha bindjet e kisha ndjenjat ndaj së djeshmes, ndaj së përtashmes dhe ndaj së ardhmes sonë.

Një jetë të plotë kam jetuar me idetë, idealet, përkushtimet, bindjet e ndjenjat ndaj së djeshmes, ndaj së përtashmes dhe ndaj së ardhmes sonë.

Dhe, varësisht prej këtyre ideve, idealeve, përkushtimeve, bindjeve, ndjenjave do të shpreh adhurimet e mia për to dhe do të hetoj sendërtimin a mohimin e tyre në jetën politike, shoqërore, kulturore, në përtashësinë e në historinë në përgjithësi.

Prej shumë shkrimeve për Lirinë, të Vërtetën e të Drejtën të shtetarëve e të krijuesve të shquar të njerëzimit për to po i paraqes këtu shkurtimisht dy.

Së pari, po i citoj mendimet e dy shtetarëve të lavdishëm për Lirinë prej së cilës varet pavarësia mendimore e njeriut dhe pavarësia shtetërore e popullit. Njëri thotë, shkurt: “Më e rëndësishme se paqja është Liria”, kurse tjetri: “Luftërat janë më të mira se disa lloje të paqes”.

Së dyti, po paraqes disa mendime të disa krijuesve - filozofë, shkencëtarë, shkrimtarë, regjisorë, intelektualë të ndryshëm.

Ata kanë folur e janë shprehur me shkrim kush për Lirinë, kush për të Vërtetën, kush për të Drejtën e kush prej tyre për të tria këto vlera madhështore.

Ata kanë thënë: krim nuk është vetëm vrasja e njeriut, krim është edhe vrasja e Lirisë dhe është krim madje me pasoja të shumta e të shumëllojshme. Mund të thuhet kështu sepse kur vritet Liria pasojisht vriten shumë e shumë njerëz, shumë e shumë njerëz të dy gjinive dhe të të gjitha moshave. Dhe, kur vritet Liria pashmangshëm vriten kushtet që e bëjnë të mundshme dhe që e bëjnë të vlefshme, të rëndësishme, të dashur jetën e njeriut. Mund të thuhet kështu sepse kur vritet Liria fitojnë shumë të këqija. Në vend të Lirisë kur e kur ngadhënjën Robëria! Në vend të Lirisë ngadhënjëjnë: kur e kur Despotizmi! Kur e kur Diktatura! Kur e kur Fashizmi!

Ata kanë thënë, po kështu: se krim nuk është vetëm vrasja e njeriut po krim është edhe vrasja e së Vërtetës. Dhe, si pasojë e vrasjes së të Vërtetës, po ashtu ndodh të vriten shumë njerëz të të dy gjinive dhe të të gjitha moshave. Dhe, si pasojë e vrasjes së të Vërtetës, fitojnë, ngadhënjajnë, triumfojnë të këqija të ndryshme shoqërore, politike, shtetërore, morale! E të tjera. Dhe, jo pak realizues dhe shfrytëzues të këtyre të këqijave me vrasjen e të vërtetës zgjerojnë mirëqenien e tyre të përkohshme, por edhe mosdurimin e urrejtjen e përhershme.

Ata kanë thënë: krim nuk është vetëm vrasja e njeriut po krim është edhe vrasja e së Drejtës. Dhe, vrasja e së Drejtës është krim, krim shumë i rëndë sepse me vrasjen e saj mund të vriten shumë e shumë njerëz të të dyja gjinive dhe të të gjitha moshave. Si kur vriten Liria dhe e Vërteta ashtu edhe kur vritet e Drejta njëkohësisht vriten edhe shumë e shumë vlera shoqërore, politike, shtetërore, arsimore, shëndetësore, morale, të djeshme, të sotme dhe të ardhshme! Dhe, këta, vrasësit e të Drejtës janë kampionë të praktikës tragjike të vrasjes së vlerave të sipërthëna të jetës së njerëzve që shpejt e vendosmërisht përndiqen prej ligjeve dhe institucioneve që zbatojnë ligjet.

Kush janë vrasësit më të shpeshtë të këtyre vlerave madhështore?

Cilat janë mjetet e vrasësve?

Me çka vrasësit e realizojnë krimin e tyre mbi Lirinë, mbi të Vërtetën dhe mbi të Drejtën?

Nuk ka dyshim se ata vrasarë janë me punësime e mundësi të ndryshme, prandaj dhe mjetet e tyre vrasare janë dhe mund të jenë të ndryshme.

Liria shpesh vritet me politikë, me ideologji, me anarki politike, shoqërore, institucionale, që bëhen mjete të vrasësve.

Për vrasjen e së Vërtetës shpesh, shumë shpesh, shërbejnë leverditë e ndryshme, interesat e ndryshme, përkatësitë e ndryshme, urrejtjet e ndryshme. E të tjera.

E Drejta dhe Drejtësia ndërkaq janë vrasarë në të shkuarën, vriten sot, në të përtashmen, dhe do të vriten edhe në të ardhmen me mjete të shumëllojshme, me mjete të ndryshme që kanë pasoja shumë të mëdha, me lokalizma të ndryshme, me politika e me ideologji të ndryshme, me “atdhetarizma” të ndryshëm, që Faik Konica i quante atdhetarizma të mëhallës dhe me autorizime zyrtare institucionale e kur e kur me frymëzime materiale, domethënë mjesisht të lëndëzuara!

Nuk është e lehtë të thuhet, megjithëse të thuhet është shumë më e ndershme se të heshtet, se popullin shqiptar, të djeshmen e tij, historinë e tij, të sotmen e tij dhe të ardhmen e tij e kanë munduar, dhe, si po shihet, edhe shumë kohë do ta mendojnë të këqija të ndryshme, që krijohen, si mjete të vrasësve të Lirisë, të së Vërtetës dhe të së Drejtës.

E djeshmja, historia jo rrallë është rënduar, është stërkeqësuar me shumë të këqija që e stërkeqin edhe sot. Kështu, fjala vjen, e kaluara, historia stërkeqen me gënjeshtër, me mashtrime, me shembuj të rrejshëm, me shëmbëlltira jo përkatëse, që ishin dhe janë në shërbim të grupeve, të politikave e të ideologjive të atyre grupeve e jo të Kombit. Shembuj dëshmues për këtë stërkeqësim janë jo vetëm historia e politikës dhe e shtetit, por edhe historitë e letërsisë e arteve të tjera dhe shkencave të ndryshme. Por, e kaluara, historia më së shpeshti stërkeqen, keqpërdoren e shpërdoren me gjuhën jo përkatëse, me gjuhën e ashtuquajtur retorikë dhe me ndjesinë e ashtuquajtur patetikë. Edhe retorika, edhe patetika dëgjohen e duartrokiten edhe sot kur flitet e shkruhet për të djeshmen, për ngjarje a shëmbëlltira historike kur e kur të rrejshme, të zmadhuara rrejshëm!

Vrasjen e Lirisë, të së Vërtetës e të së Drejtës në të ardhmen më së shpeshti e kanë bërë e do ta bëjnë të mundshme të këqijat e ndryshme që ua kanë zënë vendin vlerave. Në jetën tonë shoqërore, politike, në arsimin, në shëndetësinë, në ekonominë, në kulturën, në mediat, në administratën, në institucionet zyrtare dhe në institucionet private shpesh vlerave ua zënë vendin kundërvlerat, jo vlerat e ndryshme. Kështu, në vend të nderit e zë vendin pandershmëria, në vend të së vërtetës gënjeshtër, në vend të ligjit paligjësia, në vend të dinjitetit servilizmi, në vend të besnikërisë rrena e tradhtia, në vend të përkushtimit demagogjia, në vend të besës dyfytërsia, në vend të sinqeritetit hipokrizia, në vend të fjalës së mbajtur mashtrimi, në vend të moralit jomoraliteti.

Këto të këqija, këto shpërftyrime, këto stërkeqje, këto kundërvlera i kanosen edhe së ardhmes. Dhe, i kanosen së ardhmes në radhë të parë prej figurave politike mashtruese, të padije dhe pa përgjegjësinë e nevojshme që duhet të kenë zyrtarët, por që nuk janë në gjendje të shohin përtej kthesës së parë dhe që nuk kanë dije, nuk kanë ndërgjegje, nuk kanë përkushtim ta mendojnë e ta kuptojnë të ardhmen e shtetit në shërbim të të cilit i ka caktuar fati i zi i shtetit! Ata i dëshirojnë, mund t'i mendojnë e mund t'i kuptojnë vetë ato hapësira që shohin dhe ato kohë në të cilat kapardisen, sepse në to lehtë e shpejt e sigurt i realizojnë qëllimet e tyre, i kënaqin leverditë e tyre, i pasurojnë xhepat, fondet, prestigjet e tyre o sa të përkohshme!

Duke i paraqitur këto të këqija në jetën tonë politike, shoqërore, shtetërore, që i cenojnë, që i rrezikojnë Lirinë, të Vërtetën e të Drejtën kisha dhe kam për qëllim t'u shërbej të mirave, vlerave, virtyteve, mirëqenies së qytetarëve, popullit në përgjithësi.

Kisha bindjet, kisha dhe qëllimet, kisha ndjenjat, kisha idetë dhe idealin dhe nuk kurseja as kohë, as përkushtim për realizmin e tyre mendor.

Një jetë të tërë kam jetuar me to, për to e për ndriçimin e tyre duke menduar për frytet e tyre e jo për pasojat e mundshme të tyre në jetën time. Nuk kam menduar nëse karakterin e theksuar kritik të numrit më të madh të shkrimeve të mia për Lirinë, të Vërtetën, të Drejtën, ndërkaq, mund të mos e durojnë, mund të mos e pranojnë jo pak individë, organizata e forca politike. Dhe ata e ato do të më përgjigjen në mënyrat e tyre cenuese kur e kur kërcënuese.

Haraçi i paguar për shkrimet e tilla nuk do të jetë as i paktë e as i rrallë. Do ta paguaj unë e do ta paguajnë familjarët e mi si deri tash.

Si e ku dhe prej kujt nuk do ta them kësaj here.

Por, kurrfarë ndëshkimi, kurrfarë haraçi nuk ka mundur dhe nuk do të mund të më privojë prej bindjes se Popullit që më ka lindur, që më ka rritur, që më ka shkolluar, që më ka bërë ky që jam, do të jem i gatshëm dhe i vendosur me krejt çka mundem e di për t'i shërbyer pamohueshëm, për t'i trajtuar drejt, për t'i mbrojtur haptas e për t'i shquar qartë e zëshëm Lirinë, të Vërtetën, të Drejtën dhe natyrisht Demokracinë si Vlera që e ndriçojnë dhe e lartësojnë jetën e tij.

Kam jetuar, kam menduar e kam vepruar me bindjen se qytetarëve, se popullit, se Kombit, se të ardhmes së tij mund t'i shërbehet si duhet e sa duhet, cilësisht e sasiorisht, ndershëm, frytshëm, kurrë me mashtrime e me gënjeshtër sado të zbukuruar u qofshin ato, por vetëm me të Vërtetën e me të Drejtën qofshin ato kur e kur edhe të padëshiruara.

*Prishtinë  
16.1.2024*





NGJARJE, DUKURI, ÇËSHTJE PROGRAMORE TË SË  
DJESHMES, TË SË SOTMES DHE TË SË ARDHMES



## HAPËSIRA KULTURORE SHQIPTARE

Duke pranuar të paraqes parafjalën në këtë tubim të krijuesve dhe të punonjësve të tjerë të kulturës shqiptare dëshiroj të solidarizohem me shoqërinë kulturore *Migjeni* dhe me revistën e saj *Alternativa*, të cilat, prej se ekzistojnë, kanë bërë shumë që hapësira kulturore shqiptare të jetë sa më e gjerë dhe që e vërteta për Kosovën të përhapet edhe përtej saj. Me punën e tyre ato i kanë zgjuar ndërgjegjet tona dhe e kanë ngritur guximin tonë intelektual.

Tema rreth së cilës na ka bashkuar kjo shoqëri dhe revista e saj, që titullohet *Hapësira kulturore shqiptare*, është një temë shumëfish e rëndësishme sa për kulturën aq edhe për qenien shqiptare, sepse kultura është shprehja më e denjë e qenies së një populli. Rreth kësaj teme ndonjëri prej nesh mund të ketë thënë ndonjë mendim në mjete të informimit a mund të ketë botuar ndonjë artikull në gazetë, por bashkërisht nuk jemi ulur ta diskutojmë asnjëherë. Nuk e kemi diskutuar jo pse nuk e kemi ditur rëndësinë e saj, por pse nuk kemi qenë të sigurt se diskutimi i saj nuk do të na sjellë pasoja të padëshiruara. Para katër vjetësh mu këtu, në Lubjanë, në gazetën *Delo*, është botuar një intervistë me një intelektual shqiptar nga Kosova në të cilën, përpos të tjerash, është folur edhe për hapësirën e përbashkët kulturore shqiptare, në të vërtetë për mosekzistimin e kësaj hapësire qoftë edhe brenda Jugosllavisë dhe për masat që merr regjimi serb, malazias, maqedonas “jugosllav” për mosekzistimin e saj. Për shkak të mendimeve të shfaqura pikërisht në lidhje me hapësirën kulturore shqiptare, kjo intervistë do të shkaktojë mbi dyzet reagime në formë letrash a artikujsh në shtypin e gjuhës serbokroate dhe maqedonase, kurse gazeta *Delo*, për t’u mbrojtur prej vërejtjeve se ka favorizuar autorin e intervistuar, do të shtrëngohet që, për afërsisht të njëjtat pyetje, që ia kishte bërë atij, t’ua bënte edhe dy të tjerëve: një punonjësi politik dhe një intelektual serb nga Prishtina. A ka nevojë të thuhet se përgjigjet e tyre ishin plotësisht të kundërta me përgjigjet e autorit që mbron hapësirën kulturore shqiptare.

Duhet ta kemi të qartë se edhe sot, katër vjet më vonë - kur shteti jugosllav ka hyrë në demokraci parlamentare, që po funksionon vetëm në dy republika, në Slloveni e në Kosovë, kur ka pranuar zgjedhjet e lira e të drejtpërdrejta dhe kur ka pranuar obligime ndërkombëtare që qytetarëve t'ua sigurojë të drejtat e njeriut dhe të drejtat politike sipas standardeve botërore, duhet pra ta kemi të qartë se edhe sot, në kushte politike të tërrnuara, tema që do të trajtojmë mund të shkaktojë, në mos jo reagime të vrazhda çfarë ka shkaktuar para katër vjetësh, atëherë së paku dyshime të qarta në qëllimet e organizuesit dhe të diskutuesve.

Pse mund të thuhet kështu?

Sintagmat hapësira kulturore shqiptare, hapësira e përbashkët kulturore shqiptare, komunikimi kulturor gjithëkombëtar e të tjera të ngjashme janë sintagma të cilat objektivisht duhet të përbëjnë kornizën e politikës sonë ndaj kulturës shqiptare që po ndiqet qe dhjetë vjet e që janë në kundërshtim me masat dhe synimet përfundimtare të politikës serbe. Për më tepër, këto sintagma janë në kundërshtim me politikën që në Serbi, në Maqedoni dhe në Mal të Zi në pjesën më të madhe të kohës ndiqet ndaj kulturës shqiptare qe 78 vjet. Duhet kohë dhe duhet mund që të studiohen pësimet që kjo politikë i ka sjellë kulturës shqiptare, sidomos deri në vitin 1945; duhet kohë dhe duhet mund që të studiohen trajtat e shtypjes që kjo politikë ka zbatuar mbi kulturën shqiptare prej vitit 1945 deri në vitin 1966. Masat që janë zbatuar mbi kulturën shqiptare prej vitit 1981 e deri sot, ndërkaq, sikur i ndriçojnë masat që ndaj kësaj kulture janë marrë në vitet e përmendura dhe sikur bëjnë të mundshme të supozohen të gjitha pësimet që ajo atëherë ka pësuar.

Dhjetë vitet e fundit kanë dëshmuar, njëherë e përgjithmonë, se regjimet serbe, pavarësisht se me çfarë mbulesash ideologjike janë mbuluar, kurrë nuk kanë mundë të pajtohen me ekzistimin e lirë të arsimit dhe të kulturës shqiptare në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, sepse, sikundër është parë tragjikisht dhjetë vjetëve të fundit, kurrë nuk kanë mundë të pajtohen me qenien e shqiptarëve në këto troje ku ata jetojnë me shekuj. Për këtë arsye këto regjime, përpos në meskohën ndërmjet viteve 1966-1980, vazhdimisht janë përpjekur ta bëjnë të pamundshëm ekzistimin e hapësirës kulturore shqiptare, që do të mund të quhej e përbashkët, gjithëkombëtare, por edhe të hapësirës së njësuar kulturore shqiptare në Jugosllavi. Është bërë çmos, janë shpikur metoda të ndryshme dhe janë zbatuar masa të ndryshme, që të pengohet çdo ide mbi hapësirën e përbashkët kulturore shqiptare dhe është dënuar çdo përpjekje që do të shpinte në drejtim të

krijimit të saj. E vërteta se shqiptarët janë një popull, se kanë një gjuhë, se ajo gjuhë sot ekziston si gjuhë e njësuar letrare, se kanë një traditë kulturore dhe një traditë historike nuk është marrë kurrë parasys.

Hapësira e përbashkët kulturore shqiptare, që do të duhet të ndërtohej mbi këtë të vërtetë, në vazhdimësi është penguar, në të vërtetë është luftuar, me nocionet irredentizëm, separatizëm e viteve të fundit edhe me nocionin kundërrevolucion, si nocione mbi të cilat është bazuar politika e presionit dhe e terrorit shtetëror mbi shqiptarët në mënyrë të veçantë pas vitit 1981. Mund të vërehet, ndërkaq, se politika serbomadhe ndaj kulturës shqiptare është ndërtuar jo vetëm në strategjinë e pengimit të hapësirës etnike kulturore shqiptare, por edhe në copëtimin sa më të imtë të saj. Për këtë arsye, sigurisht, shqiptarët në Jugosllavi edhe janë ndarë në tri republika, kurse shqiptarët në Serbi në një krahinë gjysmautonome dhe në tri komuna të Serbisë Jugore. Për këtë arsye, sigurisht, janë bërë edhe një sërë përpjekjesh që synojnë çintegrimin sa më të theksuar të kulturës shqiptare prej vitit 1981 e deri sot.

Njëra prej masave të tilla me të cilat është penguar ideja e hapësirës së përbashkët kulturore shqiptare (edhe përpara vitit 1981) është teza mbi ekzistimin e dy traditave kulturore shqiptare: të traditës kulturore të Shqipërisë dhe të traditës kulturore të Kosovës. Kjo tezë, e shpikur në qarqet intelektuale e politike serbe, mund të jetë në Kosovë e mund të jetë edhe në Beograd, një kohë ka gëzuar edhe përkrahjen e pavetëdijshme të ndonjë intelektualit shqiptar natyrisht të ndonjë intelektualit që nuk e ka kuptuar me kohë se ku shpie ajo tezë. Si rezultat tragjik i kësaj teze janë edhe disa antologji apo krestomaci që janë botuar para disa dhjetëvjetëshash apo, madje, edhe para disa vitesh në Prishtinë e në Shkup.

Masa tjetër me të cilën është penguar ideja mbi hapësirën e përbashkët kulturore shqiptare, me të cilën në të vërtetë është copëtuar më tej hapësira kulturore shqiptare, është pengimi me çdo kusht i lidhjeve kulturore ndërmjet shqiptarëve në Jugosllavi dhe Shqipërisë. Sa shumë fjalë janë shqiptuar dhjetë viteve të fundit kundër bashkëpunimit kulturor mes Kosovës dhe Shqipërisë deri në vitin 1981! Sa shumë shpifje janë trilluar kundër këtij bashkëpunimi! Sa individë janë akuzuar pse i kanë kontribuar atij bashkëpunimi! Sa intelektualë janë ndjekur politikisht vetëm pse nuk kanë pranuar të deklarohen kundër atij bashkëpunimi!

Me qëllim që njëherë e përgjithmonë të hiqet dorë prej idesë mbi hapësirën e përbashkët kulturore shqiptare, që hapësira kulturore shqiptare

të jetë sa më e copëtuar, shumë studentë, nxënës apo intelektualë janë ndjekur penalisht pse kanë lexuar disa vepra të ndaluara, të botuara në Shqipëri apo në botën e jashtme, e që janë quajtur të ndaluara, pse në shtëpi u janë gjetur veprat e këtij apo të atij autori shqiptar, kjo apo ajo gazetë e revistë e inkriminuar, fotografia e kësaj e asaj figure kulturore a historike! Me qëllim që njëherë e përgjithmonë të hiqet dorë prej idesë mbi hapësirën e përbashkët kulturore shqiptare në Maqedoni janë nxjerrë prej bibliotekave afër 70 vepra të autorëve shqiptarë, midis të cilave edhe disa vepra të autorëve kosovarë; intelektualët shqiptarë nga Maqedonia janë shpallur të dyshimtë në qoftë se janë parë duke komunikuar me kolegët e tyre në Kosovë, kurse studentëve shqiptarë nga Maqedonia që studiojnë në Kosovë u është bërë i pamundshëm punësimi në Maqedoni.

Investim i veçantë i politikës së shtypjes kundër idesë mbi hapësirën e përbashkët kulturore shqiptare mund të konsiderohet rrëgjimi (reduktimi) i programeve të historisë dhe, sidomos, të letërsisë shqipe për shkollat fillore dhe të mesme. Për këtë qëllim prej programeve të letërsisë shqipe janë hequr disa vepra të traditës apo të bashkëkohësisë dhe janë hequr me pretekstin pse përmbajnë ide, mendime e figura që ndikojnë në të ashtuquajturin indoktrinim të rinisë! Për këtë qëllim prej programeve të letërsisë shqipe janë hequr disa autorë dhe janë hequr me pretekstin se gjoja janë deklaruar si kundërshtarë të Jugosllavisë, përkatësisht të Serbisë. Shkrimtari i njohur serb, Dobrica Qosiq, ka deklaruar me një rast se “Në Europë nuk ka dhe nuk do të ketë komb që për hir të Bashkësisë Europiane, të tregut të përbashkët, të monedhës së përbashkët apo të televizionit të përbashkët do të heqë dorë nga Shekspiri, Rasini, Dante a Gëte. Grekët nuk do të heqin dorë nga Homeri, Eskili po Sofokliu. As ne, serbët, thotë ai, nuk do të heqim dorë nga poezia epike, nga Njegoshi a Vuku. Sllovenët nuk do të heqin dorë nga Presherni e Kocbeku, mos të numërojmë më tutje”. Por prej shqiptarëve është kërkuar, me çdo kusht është kërkuar, që të heqin dorë prej disa veprave të Naimit e të Mjedjes, kurse në tërësi prej Fishtës, prej Nolit, prej Dritëro Agollit dhe prej Ismail Kadaresë! Është kërkuar dhe kjo kërkesë barbare është realizuar për një kohë.

Nuk ka dyshim se strategjisë mohuese politike ndaj idesë mbi hapësirën e përbashkët kulturore shqiptare i takojnë edhe reagimet negative të disa qarqeve intelektuale serbe, në mënyrë të veçantë të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve ndaj gjuhës letrare shqipe dhe ndaj Kongresit të Drejtshkrimit të vitit 1972. Jo njëherë disa prej anëtarëve të kësaj Akademie

kanë shprehur keqardhje pse është lejuar pjesëmarrja e shqiptarëve nga Jugosllavia në këtë Kongres dhe, rrjedhimisht, pse është bërë e mundshme që gjuha e njësuar letrare shqipe të bëhet gjuhë në të cilën do të shkruajnë edhe shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi!

Shkencëtarët e politizuar serbë, sado anëtarë të Akademisë janë bërë në saje të punës shkencore, kur është në pyetje gjuha letrare shqipe dhe, në përgjithësi kultura shqiptare, nuk respektojnë kurrfarë logjike shkencore! Ata e dinë, dhe disa prej tyre e theksojnë, se krijimi i gjuhës letrare (gjithmonë e gjithkund) është çështje e procedurës në të cilën angazhohen shumë faktorë historikë, por kur flasim për krijimin e gjuhës letrare shqipe pa një pa dy heqin dorë prej kësaj të vërtete dhe krijimin e gjuhës letrare shqipe ia atribuojnë kryekëput faktorit politik! Nuk ka dyshim se gjuha e pafajshme letrare shqipe është gjetur kështu në shënjestrën e sulmeve të tyre për arsye se janë plotësisht të vetëdijshëm se gjuha letrare kombëtare gjithmonë dhe gjithkund bëhet faktor themelor i njësimi të hapësirës kulturore kombëtare.

Të gjitha masat e lartpërmendura kundërqytetëruese të marra kundër kulturës shqiptare gjatë dhjetë viteve të fundit, të marra me qëllim të copëtimit të hapësirës kulturore shqiptare sipas shembullit të copëtimit etnik të vetë popullit shqiptar, në pjesën më të madhe të rasteve janë arsyetuar dhe arsyetohen me nevojën e të ashtuquajturit integrim të shqiptarëve, domethënë të kulturës së tyre, në hapësirën kulturore jugosllave. Në asnjë rast nuk është marrë parasysh se kultura shqiptare nuk është kulturë sllave, prandaj as jugosllave, që të mund të integrohet në të. Është harruar fakti se ajo është kulturë e mëvetësishme, e krijuar prej një populli, me gjuhë të vet, me mentalitet, me traditë dhe me histori të vet, se është kulturë e një populli e krijuar në komunikim me kulturat e popujve të tjerë të Perëndimit dhe të Lindjes, por e një populli që në kulturën e vet, para së gjithash, ka projektuar ndjenjat dhe mendimet e veta, dhembjet dhe gëzimet e veta, gjendjen dhe synimet e veta dhe, më në fund, gjeniun e vet.

Parulla mbi nevojën e integritetit të kulturës shqiptare në kulturën jugosllave doemos tingëllon si kërkesë - e thënë me një fjalë tjetër, politikisht më të rafinuar - që në fund të fundit nënkupton dorëheqjen vullnetare të shqiptarëve nga identiteti dhe integriteti i tyre shpirtëror. Po kjo parullë, parulla mbi integritetin e kulturës shqiptare në kulturën jugosllave, në të vërtetë është një prej atyre parullave me të cilën shqiptarët duhet të zateteshin për muri, të akuzuar si fajtorë të shpikur për krizën jugosllave!

Gatishmëria e integritit të kulturës së tyre në kulturën jugosllave do të duhej të ishte shpagim për gjoja rolin e tyre në dezintegrimin e kulturës, përkatësisht të shtetit jugosllav.

Masat e lartpërmendura që janë marrë kundër hapësirës së përbashkët kulturore shqiptare dhe kërkesat e lartpërmendura që i janë bërë kulturës shqiptare gjatë dhjetë viteve të fundit doemos kanë lënë pasojat të rënda si në kulturën tonë ashtu edhe në krijuesit e saj. Kultura jonë sot duket e varfëruar shumë; energjitë tona krijuese janë tkurrur tepër; trajtat e jetës sonë kulturore jashtëzakonisht janë thjeshtësuar. Jeta jonë është rrëgjuar (reduktuar) në përmasën politike, por në përmasën më brutale dhe moralisht më të dyshimtë politike. Shkaktar i të gjitha këtyre pësimeve të kulturës shqiptare dihet kush është: politika kundërshqiptare e Serbisë së sotme, politikë plotësisht e kundërt me prirjet e qytetërimit modern, plotësisht e kundërt me parimet e demokracisë dhe të humanizmit, plotësisht e kundërt me proceset historike, prandaj edhe e pa kurrfarë perspektive më të gjatë.

Nuk mund të mos thuhet, ndërkaq, se prej fajit për pasojat që një politikë e tillë i ka sjellë hapësirës së përbashkët kulturore shqiptare dhe kulturës shqiptare në përgjithësi, nuk mund të lirohen as politikanët shqiptarë, të cilët etja për pushtet dhe karrierizmi i kanë shtyrë të bëhen dora e zgjatur e asaj politike.

Prej fajit për pasojat që një politikë e tillë i ka sjellë hapësirës kulturore shqiptare dhe kulturës shqiptare, në përgjithësi, nuk mund të lirohet as një pjesë e inteligjencies shqiptare, një pjesë madje, e madhe, e saj, e cila gjatë, gjatë, deri te shpallja e sistemit shumëpartiak në Jugosllavi, ka jetuar si shërbëtoreshë e regjimit, ka ruajtur privilegjet e veta, prandaj ka folur si e donte regjimi ose ka heshtur për të gjitha ato masa që janë marrë dhe për të gjitha ato kërkesa barbare që i janë bërë kulturës sonë! Dëshira e inteligjencies politike, humaniste dhe teknike, që të ruajnë privilegjet e veta ka bërë që pasojat e politikës kundërshqiptare serbe prej vitit 1981 e deri në fillim të vitit 1990 të bien tragjikisht mbi supet e masave popullore shqiptare: mbi supet e fshatarëve e të punëtorëve, sidomos të bijve e të bijave të tyre. Për këtë arsye edhe përkushtimi im gjithnjë u është dhuruar dhe u dhurohet vetëm atyre. A duhet të theksohet se rezultat i politikës së tillë të Serbisë së sotme, i sjelljeve të tilla kundërkombëtare të faktorit politik shqiptar dhe i heshtjes së gjatë, mortore, të një pjese të madhe të inteligjencies sonë, sot është gjendja në të cilën gjendemi:



ngecja e përgjithshme në zhvillimin tonë, ngecja në fushën e kulturës, të arsimit, të shëndetësisë, të ekonomisë, jeta e padurueshme politike, pabarazia e madhe, e paparë deri sot në Europë, e një populli; varfëria të cilën s'ë përjeton asnjë popull i Europës sot; përlulja e diskriminimi; eksploatimi; shkelja brutale e të drejtave të njeriut e të popullit; shtypja e terrori shtetëror, që deri dje mbuloheshin me ideologjinë komuniste e sot mbulohen me paragrafë të shtetit juridik; shpërndarja, shpërndarja në kuptimin tragjik të kësaj fjale, e pjesës më aktive dhe më të shëndoshë të popullatës nëpër botë. E të tjera.

Mungesa e përvojës së vërtetë politike, në njërin anë, kurse ambiciet lideriste, në anën tjetër, shumëkë prej nesh e bëjnë prodhues të iluzioneve se sot, kur ne po flasim çka po duam, kurse regjimi i Slllobodan Millosheviqit po bën çka po don në Kosovën e okupuar me policë, gjendja jonë është më e mirë se dje! Më e mirë mund të jetë vetëm në shikim të parë, në sipërfaqe, se përbrenda, në thellësitë e jetës sonë, më mirë nuk është aspak. Se, rezultatet e dhunës shumëvjeçare politike dhe shtetërore kanë filluar të stabilizohen si realitet, natyrisht si realitet i hidhur.

Në Afrikë sot po merr fund politika e aparteidit, por një politikë e tillë po zbatohet në Kosovë.

Në Afrikë po merr fund politika e kolonializmit. Namibia e shpallur shtet i pavarur para një kohe, ishte kolonia e fundit në këtë kontinent, por Kosova objektivisht është në pozitë kolonie.

Në Afrikë po merr fund politika e kolonizimit, por në Kosovën e banuar më së denduri në Europë, kolonizimi po vazhdon.

Në Afrikë kulturat kombëtare sot funksionojnë lirisht, si kultura kombëtare pavarësisht prej kufijve që mund t'i ndajnë pjesëtarët e një kombi, e në Jugosllavi shqiptarëve ende nuk u lejohet komunikimi kulturor gjithëkombëtar: nuk u lejohet komunikimi kulturor jo vetëm me Shqipërinë, por as brenda republikave jugosllave! Në këtë mënyrë historia e më tepër se dy milionë shqiptarëve në jugosllavi ngjet në drejtim të kundërt: ecën përmbropa!

Domosdonë e qenies së hapësirës së përbashkët kulturore shqiptare e theksojmë dhe për të nuk përpiqemi-natyrisht ne që e theksojmë dhe ne që për të përpiqemi, me qëllim që, ashtu, ta izolojmë kulturën tonë prej kulturave të tjera e aq më pak prej kulturave të popujve ballkanikë me të cilët me shekuj e kemi pasur fatin e përbashkët historik, me të cilët me shekuj kemi jetuar në fqinjësi, me të cilët dëshirojmë të jetojmë në fqinjësi të

mirë, në miqësi dhe nderim të ndërsjellë. Domosdonë e qenies së hapësirës së përbashkët kulturore shqiptare e theksojmë dhe për të përpiqemi me qëllim që, ashtu, të ruajmë, të ruajmë dhe të zhvillojmë, identitetin dhe integritetin tonë shpirtëror; me qëllim që ashtu kulturën tonë kombëtare ta bëjmë më të aftë për komunikim sa më të fortë, më të gjithanshëm dhe më të barabartë me kulturat e popujve të tjerë, prandaj edhe me kulturat e popujve të Jugosllavisë. Kombëtarja për ne është njëkohësisht mundësi që përmes saj të shprehet edhe botërorja, universalja, që përmes saj të zhvillohet sa më gjithanshëm individi, si individ i lirë dhe populli si popull i lirë.

Por të përfundoj.

Nuk jam i pari që them dhe nuk e them sot këtu për herë të parë se çështja shqiptare është çështja më e ndërlikuar, më e rëndë në Ballkan.

Pse?

Sepse shqiptarët janë populli etnikisht më i cenuar jo vetëm në Ballkan, por edhe në Europë. Vetëm ata jetojnë në pesë shtete të Ballkanit, kurse numri i shqiptarëve në diasporë në krahasim me numrin e Shqiptarëve në shtetin amë e në Jugosllavi është më i madhi në botë. Po të krahasojmë këta numra - numrin e shqiptarëve në botë dhe numrin e shqiptarëve që jetojnë në Shqipëri dhe në Jugosllavi do të mund të shtrohet pyetja tragjike: mos nënat shqiptare me shekuj lindin fëmijë për botën! Por, siç ka thënë krijuesi sot më i vjetër dhe më autoritativ slloven, Josip Vidmar: “Duhet të jetohet. Duhet të jetojë edhe populli rëndë i cenuar. Populli që është rëndë i cenuar si tërësi. Se asgjë tjetër s’i mbetet bashkësisë së cenuar pos që të gjejë trajtë tjetër të jetës së përbashkët për tërësinë e vet, që do të ishte e lirë dhe që do ta lidhte me sivëllezërit, s’i mbetet asgjë tjetër pos jetës së përbashkët në zemër, në jetën e brendshme, që në mënyrën me autentike shprehet në kulturën, domethënë në artin dhe në synimet shpirtërore, në zhvillimin shpirtëror. Prej vetëdijes për këtë ka lindur mes nesh ideja mbi hapësirën e përbashkët kulturore, që nuk njeh kufij ose që nuk duhet të njohë kufij as shtete, as çfarëdo qoftë kufijsh të tjerë që do ta pengonin. Shpirti është i lirë, fluturon nga të dojë dhe jeton si të dojë, i nënshtrohet vetëm vetes, parafytyrimit të vet në shprehitë e njerëzve që e bartin dhe që me ndihmën e tij krijojnë. Kjo hapësirë, natyrisht, ekziston vetvetiu, por këtë hapësirë duhet ta mbushim me përmbajtje të çmuar dhe qëllimore...” Kjo hapësirë e përbashkët kulturore do të jetë një si kompensim për mungesën e sotme, për cenimin e sotëm, për padrejtësinë e sotme. Kjo hapësirë do

të jetë kompensim deri atëherë kur Europa të kujtohet se Ballkanin e ka ndërlikuar ajo vetë, se çështjen shqiptare ajo, Europa, e ka krijuar me laps në dorë, pranë tryezës dhe ajo, Europa, me laps në dorë, pranë tryezës, edhe duhet ta zgjidhë. Dhe duhet ta zgjidhë për të mirë të popullit shqiptar, aq të cenuar, e aq të shtypur deri sot, për të mirë të të gjithë popujve të Ballkanit dhe për të mirë të Europës. Europa e bashkuar, e popujve të bashkuar, por të lirë të Europës, duhet të ndihmojë të zgjidhet edhe çështja shqiptare duke ia pranuar popullit shqiptar në Jugosllavi të drejtën e Vetëvendosjes. Europa e bashkuar, e popujve të bashkuar por të lirë të Europës, duhet të ndihmojë të zgjidhet edhe çështja shqiptare duke ia pranuar popullit shqiptar në Jugosllavi të drejtën legjitime që të jetë i barabartë me popujt e tjerë në Jugosllavi. E i barabartë me të tjerët në jugosllavi ai mund të jetë vetëm në Republikën që do të quhej Republika e Kosovës.

Në të vërtetë Kosova e ardhshme e lirë, e pavarur e sovrane, që një ditë do të bashkohet me shtetin amë kombëtar: me Shqipërinë.

*1990*

## **TË GJITHA KOSOVAT POLITIKE**

Shikuar historikisht gjatë 70 viteve të fundit në njëmendësinë kosovare janë ndërtuar disa Kosova politikisht të ndryshme.

Prej vitit 1945 e deri në vitin 1981 do ta kemi Kosovën politike jugosllavo-shqiptare, të cilën do ta mbisundojnë plotësisht ideologjia dhe politika e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Prej vitit 1981 e deri në vitin 1990 do ta kemi Kosovën politike serbo-shqiptare, të cilën do ta mbisundojë plotësisht Lidhja e Komunistëve të Serbisë me organet e saj shtetërore.

Prej vitit 1990 e deri në vitin 1999 do të kemi Kosovën e paqësuar pluraliste shqiptaro-serbe, të cilën politikisht, policorisht dhe ushtarakisht do ta sundojë Partia Socialiste e Serbisë, në bashkëpunim me partitë e djathta nacionaliste, ndër të cilat më shovinistja do të jetë Partia Radikale e Vojisllav Sheshelit, kurse retorikisht do ta ngushëllojë Lidhja Demokratike e Kosovës.

Prej vitit 1999, në të vërtetë prej qershorit të vitit 1999, kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe NATO e çlirojnë Kosovën prej pushtimit serb e deri sot do ta kemi Kosovën protektorat, viteve të fundit me përbërës gjithnjë e më bashkëveprues të pavarësisë formale dhe të kolonializmit modern!

### ***KOSOVA POLITIKE JUGOSLLAVO-SHQIPTARE***

Kjo është Kosova politike e bashkim vëllazërimit jugosllav dhe e barazisë së rrejshme të kombeve e të kombësive, por me të cilën nuk pajtohet një Kosovë tjetër politike: nuk pajtohet Kosova politike shqiptaro-shqiptare, domethënë Kosova me përkushtim historik dhe politik ndaj Shqipërisë shtetërore.

Përfaqësuesit shqiptarë të politikës jugosllave në Kosovën jugosllavo-shqiptare do të jenë pjesëmarrësit e Luftës antifashiste Fadil Hoxha, Veli Deva, Xhavit Nimani, Ali Shukriu, Sinan Hasani, Kolë Shiroka e të

tjerë. Ky brez politik shqiptar me sjelljen e tij, me shkathësinë e tij, me mendjen e tij do të arrijë të fitojë mirëkuptimin e kohëpaskohshëm të një numri fare të paktë politikanësh serbë dhe mirëkuptimin e përkrahjen e shpeshtë të një numri më të madh politikanësh kroatë, sllovenë dhe kohë pas kohe boshnjakë. Në saje të këtij mirëkuptimi, në të vërtetë të kësaj përkrahjeje politikanët shqiptarë të kësaj kohe do të arrijnë ta përparojnë Kosovën në pikëpamje kushtetutare-juridike, në pikëpamje ekonomike, në pikëpamje arsimore, shëndetësore, kulturore dhe shoqërore në përgjithësi, duke krijuar edhe institucionet më të larta të arsimit e të shkencës, si Universitetin e Prishtinës, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, një varg institutesh të tjera më të vogla, Akademinë e Shkencave e të Arteve të Kosovës, të arsimojnë vajzën shqiptare, të rrisin dukshëm numrin e shqiptarëve të punësuar, të rrisin numrin e shqiptarëve në organet e milicisë dhe të Sigurimit shtetëror. Dhe, ta bëjnë Kosovën element konstitutiv të Federatës. Ky brez politikanësh shqiptarë do të arrijë njëkohësisht të vendosë bashkëpunimin arsimor, shkencor e kulturor me Republikën e Shqipërisë, që do të ketë ndikim jashtëzakonisht të madh në ngritjen e përgjithshme kulturore të shqiptarëve të Kosovës dhe në frymëzimin e vetëdijes shtetkrijuese të rinisë shqiptare.

Me Kosovën politike jugosllavo-shqiptare nuk do të pajtohet Kosova shqiptaro-shqiptare, domethënë Kosova shqiptare me përkushtim të gjithnjëshëm, historik ndaj Shqipërisë. Klasa politike jugosllavo-shqiptare në vazhdimësi, duke filluar prej vitit 1946 e deri në vitin 1981, kur e humb pushtetin, do të qërojë hesape, kur politikisht e kur gjyqëorisht, me idealistët e Kosovës së përkushtuar ndaj Shqipërisë, domethënë me idealistët e pavarësisë së Kosovës dhe të bashkimit të saj me Shqipërinë.

Në vitin 1968 kjo klasë politike, në krye me Fadil Hoshën, ndërkaq, do të përkrahë konceptin e ngritjes së Kosovës në status republike, por do të heqë dorë prej tij kur Titoja, nën trysinë e udhëheqjes serbe, do ta quajë të palejueshëm atë status.

Demonstratat e marsit dhe të prillit të vitit 1981 do të shënojnë fundin e klasës politike jugosllavo-shqiptare. E vetëdijshme se ç'mund t'i ndodhë pas këtyre demonstratave, kjo klasë politike do t'i dënojë ato si nacionaliste e irredentiste dhe, madje, do ta pranojë karakterizimin e tyre si kundërrevolucion! Fryt i zi i zbatimit të këtij karakterizimi do të jetë procesi i të ashtuquajturit diferencim ideopolitik, që do të sjellë shumë të këqija në Kosovë. Në shërbim të zbatimit të këtij diferencimi të kobshëm

do të vihet gati në tërësi inteligjencia shqiptare, duke i shërbyer qoftë me veprimtari politike, qoftë me shkrime, qoftë me paraqitje në mjetet e informimit, qoftë me heshtjen e një numri të pjesëmarrësve të saj. Do të jetë ky një turp historik prej të cilit një numër i gjysminteletualëve dhe çerekinteletualëve të asaj kohe vetë a prej bijve të vet po lahen e shpërlahen tani me gënjeshtër të gjithfarshme!

### ***KOSOVA POLITIKE SERBO-SHQIPTARE***

Me gjithë përpjekjet e saj për t'u mbajtur në pushtet, klasa politike jugosllavo-shqiptare nuk do të mundë t'i shpëtojë ndëshkimit politik dhe shtetëror të Jugosllavisë gjithnjë e më të kapur prej udhëheqjes serbe, në të cilën po shquhej një figurë fatale politike e quajtur Slobodan Millosheviq. Menjëherë pas demonstratave të vitit 1981 në Serbi ishte bërë vendim bindja se autonomia e Kosovës e miratuar në vitin 1974 do të duhej të shpërbëhej, me politikë a me dhunë; por, për t'ia arritur "paqësisht" këtij qëllimi udhëheqja e Serbisë konsideronte se më parë duhej të përmbyste klasën politike jugosllavo-shqiptare të Kosovës. Dhe, këtij qëllimi udhëheqja serbe do t'ia arrijë në njërin anë me ndihmën e disa politikanëve shqiptarë të brezit të parë, siç ishin Ali Shukriu, Kolë Shiroka dhe Sinan Hasanit, kurse në anën tjetër me ndihmën e arrivistëve të rinj shqiptarë, që po prisnin rastin të ngriheshin mbi kufomat e sponsorëve të tyre të deridjeshëm: Fadil Hoxhës, Veli Devës, Xhavit Nimanit, Mahmut Bakallit, Ismajl Bajrës, Azem Vllasit e të tjerëve, disa prej të cilëve, si Fadil Hoxhën, duke i përjashtuar prej Lidhjes së Komunistëve e, ndonjë tjetër, si Azem Vllasin, edhe duke i burgosur. Politikën e quajtur jugosllave në Kosovë tani do ta zëvendësojë plotësisht dhe tragjikisht politika serbe, që do të jetë gjithnjë e më e vrazhdë, më nacionaliste dhe më shoviniste ndaj shqiptarëve. Prej vitit 1981, kjo politikë do ta fillojë procesin e pengimit të zhvillimit ekonomik, arsimor, shkencor, kulturor, shëndetësor, demografik të Kosovës. Institucionet përkatëse shtetërore serbe, të frymëzuara prej Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, të Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë e të Universitetit të Beogradit, që e kishin filluar një ofensivë kundër historisë, albanologjisë, letërsisë dhe traditave shqiptare në përgjithësi do të hartojnë plane për pengimin dhe prapakthimin zhvillimor të përgjithshëm të Kosovës, që do të zbatohen, deshën s'deshën shqiptarët. Në planet serbe, që po nxiteshin në Komitetin